info@rpay.ai
rpay.ai

Revision Index	Date	Description	Author	Approved by
1.0	June 2026	Initial Creation	Akil Rajdho Komola Mecaj	

TRANSFERIMI I LLOGARIVE TË PAGESËS

1) Qëllimi

Kjo procedurë përcakton rregullat dhe hapat operacionalë që ndjek RPay për ofrimin e shërbimit të transferimit të llogarive të pagesës, në përputhje me Rregulloren nr. 59/2022 të Banka e Shqipërisë. Rregullorja synon të garantojë transparencë dhe standardizim në transferimin e llogarive ndërmjet ofruesve të shërbimeve të pagesave .

2) Fusha e zbatimit

Kjo procedurë zbatohet për:

- Transferime nga RPay drejt një banke / IPE / institucioni pagese tjetër
- Transferime drejt RPay si institucion pritës
- Të gjithë klientët konsumatorë (individë)

3) Përkufizime kryesore

- Institucion transferues – ofruesi aktual i llogarisë
- Institucion pritës – ofruesi ku transferohet llogaria
- Autorizim – pëlqimi i klientit për kryerjen e transferimit

Shërbimi ofrohet vetëm për llogari në të njëjtën monedhë dhe nuk lejohet në rast bllokimi/sekuestroje .

4) Parimet rregullatore (detyrim për RPay)

RPay siguron që:

- Shërbimi i transferimit të jetë i disponueshëm për të gjithë klientët
- Procesi të iniciohet vetëm pas autorizimit të klientit
- Transferimi të kryhet brenda afateve të përcaktuara (≤ 5 ditë pune për shkëmbim informacioni)

Klienti të ketë të drejtë të:

- transferojë balancën
- anulojë urdhra periodikë
- mbyllë llogarinë ekzistuese

5) Autorizimi i klientit

a. Kërkesat minimale

Autorizimi jepet me shkrim ose në formë elektronike të qëndrueshme. Përmban:

- identifikimin e llogarive
- shërbimet që transferohen
- datën e ekzekutimit

b. Përmbajtja funksionale

Autorizimi i jep RPay (si institucion pritës ose transferues) të drejtën:

- të kërkojë informacion nga institucioni tjetër
- të transferojë fondet
- të anulojë urdhra periodikë
- të mbyllë llogarinë (nëse kërkohet)

6) Procedura kur RPay është institucion pritës

a. Inicimi

i. Klienti aplikon në RPay
ii. Firmos autorizimin standard

b. **Veprimet e RPay**

Rpay dërgon kërkesë tek institucioni transferues brenda 2 ditëve pune dhe specifikon:

i. listën e shërbimeve për transferim
ii. datën e fillimit

c. Marrja e informacionit

Institucioni transferues duhet të dërgojë brenda 5 ditëve pune:

i. urdhër-pagesat periodike
ii. mandatet e debitimit direkt
iii. informacion mbi dërguesit e transfertave hyrëse

d. Aktivizimi në RPay

RPay:

i. regjistron të dhënat
ii. aktivizon shërbimet në datën e kërkuar
iii. njofton klientin për përfundimin e procesit

7) Procedura kur RPay është institucion transferues

a. Marrja e kërkesës

i. Kërkesa merret nga institucioni pritës
ii. Verifikohet autorizimi i klientit

info@rpay.ai
rpay.ai

b. Verifikime

RPay kontrollon:

i. balancën e llogarisë
ii. bllokime/sekuestro (nëse ka → transferimi refuzohet)
iii. detyrime të papaguara

c. Veprimet brenda 5 ditëve pune

RPay:

i. Dërgon informacionin e kërkuar
ii. Ndalon transfertat hyrëse (nëse kërkohet)
iii. Anulon urdhrat periodikë
iv. Transferon balancën

8) Mbyllja e llogarisë


i. Kryhet në datën e kërkuar nga klienti
ii. Vetëm pasi janë transferuar fondet dhe shërbimet

9) Komunikimi dhe transparenca

RPay:

i. Informon klientin gjatë gjithë procesit
ii. Përdor mjete komunikimi të qëndrueshme
iii. Njofton për çdo refuzim apo vonesë

info@rpay.ai
rpay.ai



Rr. Frank Bardhi, Tiranë, Albania, Kristal Center, Kati 2.

info@rpay.ai
rpay.ai

FORMULAR AUTORIZIMI PËR TRANSFERIMIN E LLOGARISË SË PAGESËS

1. TË DHËNAT E KLIENTIT

* Emër / Mbiemër: _____
* Nr. personal (ID): _____
* Adresa: _____
* Nr. telefoni: _____
* Email: _____

2. TË DHËNAT E LLOGARISË EKZISTUESE (INSTITUCIONI TRANSFERUES)

* Emri i institucionit: _____
* IBAN / Nr. llogarie: _____
* Monedha: _____

3. TË DHËNAT E LLOGARISË PRITËSE (RPay ose institucion tjetër)

* Emri i institucionit pritës: _____
* IBAN / Nr. llogarie: _____
* Monedha: _____

4. OBJEKTI I AUTORIZIMIT

Unë/i nënshkruari autorizoj institucionin pritës dhe institucionin transferues të kryejnë transferimin e llogarisë së pagesës sipas kushteve të mëposhtme:

Shërbimet që do të transferohen (zgjidhni):

☐ Transfertat hyrëse të kreditit
☐ Urdhër-pagesat periodike (standing orders)
☐ Mandatet e debitimit direkt
☐ Transferimi i balancës së mbetur
☐ Mbyllja e llogarisë ekzistuese

5. DATA E EKZEKUTIMIT

Data nga e cila kërkoj që shërbimet të fillojnë të ekzekutohen nga institucioni pritës:

____ / ____ / _____

(Data duhet të jetë të paktën 6 ditë pune nga data e dorëzimit të këtij autorizimi)

6. AUTORIZIME SPECIFIKE

Me këtë dokument autorizoj:

Institucionin pritës të kërkojë dhe të marrë informacionin e nevojshëm nga institucioni transferues

Institucionin transferues të:

- japë listën e urdhër-pagesave dhe mandateve aktive
- japë informacion mbi transfertat hyrëse (deri në 13 muaj)
- anulojë urdhër-pagesat sipas datës së përcaktuar
- transferojë fondet në llogarinë e re

7. DEKLARATË E KLIENTIT

Deklaroj se:

- Të dhënat e dhëna janë të sakta
- Kam kuptuar të drejtat dhe detyrimet e mia lidhur me këtë proces
- Jam i informuar se transferimi mund të refuzohet në rast bllokimi/sekuestroje apo detyrimesh të papaguara
- Pranoj kushtet e transferimit sipas rregulloreve në fuqi

Klienti
Emër / Mbiemër: _____
Nënshkrimi: _____
Data: ____ / ____ / _____